



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.809/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., me seli në Prishtinë, rr.“Bill Clinton” p.nr., kundër debitorit avokat V.S. me seli të zyrës në Lipjan, rr.“Hamz Jashari” p.nr., me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.470/2022 të datës 24.04.2023, me datë 29.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit avokat Valon Sadiku me seli të zyrës në Lipjan, rr.“Hamz Jashari” p.nr., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.470/2022 i datës 24.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.470/2022 të datës 24.04.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit avokat Valon Sadiku me seli të zyrës në Lipjan, rr.“Hamz Jashari” p.nr., të ushtruar kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.164/2020 të datës 25.02.2020 të përmbaruesi privat Eset Murati me seli në Prishtinë dhe të njëjtin urdhër në tërësi e ka lënë në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të LPP-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të miratohet dhe propozimi për përmbarim të anulohet dhe të hedhet poshtë si i palejuar ose të refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., me seli në Prishtinë, rr.“Bill Clinton” p.nr., me datë 25.02.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim kundër debitorit avokat Valon Sadiku me seli të zyrës në Lipjan, rr.“Hamz Jashari” p.nr., në bazë të dokumentit besueshëm – Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me nr.137049 të datës 13.02.2020, me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit për shërbimet komunale - bartja e mbeturinave për periudhën kohore prej datës 31.01.2019 deri me datë 31.01.2020, t’ia paguajë shumën prej 70.03 Euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar dita e lejimit të përmbarrimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin.

Përmbarruesi privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.164/2020 të datës 25.02.2020, ka lejuar përmbarrimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbarrim.

Kundër këtij urdhri përmbarrimor debitori me datë 09.03.2020 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se me kreditorin nuk ka vendosur marrëdhënie kontraktuale asnjëherë dhe nga veprimtaria që realizon debitori asnjëherë nuk krijon mbeturina ashtu që të kontraktotë këto shërbime kreditorit, duke prezantuar në cilësi të provës ankesën e parashtuar tek kreditori me të cilën është ankuar menjëherë pas pranimit të faturës së parë për kryerjen e shërbimeve (06 Mars 2019, fatura nr.502739 e datës 31.01.2019, në shumën 6.51 euro), e që për të njëjtën ka theksuar nuk ka pranuar përgjigje nga kreditori asnjëherë. Tutje ka shtuar se ka disa muaj që nuk ka pranuar më fatura nga kreditori, për çka ka menduar se kreditori heshturazi e ka larguar të njëjtin nga sistemi i pagesave, andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarrimor në tërësi.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 11.03.2020, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se vendosja e raporteve kontraktuale mes kreditorit dhe pranuesve të shërbimit është e karakterit imperativ dhe ka të bëjë me mirëmbajtjen e përgjithshme të pastërtisë dhe higjienës në qytet. Tutje ka arsyetuar se kreditori paraqitet në shtetin tonë si e vetmja ndërmarrje publike në rajonin e Prishtinës me interes të veçantë shoqëror, e specializuar, e licencuar dhe e autorizuar për të kryer shërbimet e mirëmbajtjes së pastërtisë dhe higjienës publike. Po ashtu ka arsyetuar se i kundërshton pretendimet e debitorit se i njëjti nuk realizon fare mbeturina, për arsye se nuk gjendet asnjë veprimtari që nuk prodhon mbeturina. Andaj, ka propozuar që në tërësi të refuzohet si i pabazuar prapësimi dhe të lihet në fuqi urdhri përmbarrimor P.nr.164/2020 i datës 25.02.2020.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës me aktvendimin KPPP.nr.470/2022 të datës 24.04.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarrimit avokat Valon Sadiku me seli të zyrës në Lipjan, rr.“Hamz Jashari” p.nr, të ushtuar kundër Urdhrin përmbarrimor P.nr.164/2020 të datës 25.02.2020 të përmbarruesi privat Eset Murati me seli në Prishtinë dhe të njëjtin urdhër në tërësi e ka lënë në fuqi. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, dhoma e shkallës së parë, ka arsyetuar se prapësimi i debitorit të përmbarrimit është i pabazuar për arsye se i njëjti nuk i ka mbështetur në prova pretendimet e tij. Nga shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i përmbarrimit i ka

bashkëngjitur propozimit për përmbarim ekstraktin e verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit në kopje të vërtetuar nga origjinali, nga çka konstatohet përmbushja e kushteve formale të kërkuara sipas LPP-së, konkretisht nenit 29 par.1.2 dhe nenit 40 par.1.3. Tutje gjykata ka arsyetuar se pretendimet e ngritura të debitorit në prapësim janë të pavërteta, pavarësisht se debitori thirret në mos kontraktim të shërbimit me kreditorin, në këtë rast kemi të bëjmë me faturim të shërbimit komunal të mirëmbajtjes i cili ofrohet nga një kompani e autorizuar dhe licencuar që ka tagër për kryerjen e shërbimeve publike e me interes të përgjithshëm si e vetmja në rajon. Po ashtu, gjykata ka theksuar se nuk i ka pranuar argumentet e debitorit se nuk realizon fare mbeturina pasi që shërbimet e debitorit shërbimet ligjore të avokatisë ndërthejnë në vete prezencë njerëzore në zyre të cilët domosdo edhe për nevoja jetësore elementare dhe jo vetëm për biznes prodhojnë mbeturina, për të mos u lëshuar me tej në vlerësim të aktivitetit të avokatit si profesionist (gjë që është mirë e ditur nga institucionet e rendit publik). Prandaj në këtë pikë gjykata ka arsyetuar se janë me vend deklaratimet e kreditorit të dhëna me përgjigje në prapësim se debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se ku i menaxhon dhe zbraz mbeturinat e tij nga aktiviteti ditor komercial i avokatisë e që për të njëjtat gjykatës nuk i ka paraqitur asnjë dëshmi, për çka dhe ka refuzuar prapësimin e debitorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Debitori në ankesën e ushtruar ka theksuar se aktvendimi i ankimuar është nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, kur gjykata ka konstatuar se debitori ka detyrim ndaj kreditorit, për shkak se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ekziston asnjë marrëdhënie kontraktuale konkretet që kishte me i obliguar palët ta respektojnë atë punë juridike. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se sipas kësaj gjykate në rastin konkret nuk është e nevojshme të ketë marrëdhënie kontraktuale ndërmjet palëve, pasi që kemi të bëjmë me shërbimin komunal - mbledhje të mbeturinave, pagesa e të cilit shërbim është obligim për çdo konsumator qoftë amvisëri apo biznes, në rastin konkret debitori është biznes dhe i njëjti nga shkresat e lëndës rezulton se paguan tarifën me të ulët për bizneset.

Me nenin 29 par.1 pika 1.2 të LPP përcaktohet se: “1.Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji janë: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”. Ndërsa në paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Po ashtu, me nenin 37 dhe 40 par.1, pika 3 të LPP-së, përcaktohet se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm, ndërsa në rastin konkret edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate ekstrakti i lartcekur i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se e njëjta është lëshuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit si dhe është kopje e vërtetuar nga origjinali.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 të LPP-së, i cili shprehimisht përcakton se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i vlerësuan të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase pretendimet e tilla të paraqitur në këtë procedurë përmbarimore, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë konsiderojnë se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore. Andaj, me të drejtë dhoma e shkallës së parë e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit të parashtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.164/2020 të datës 25.02.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.809/2023 me datë 29.01.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha